



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 12.12.2018

Lënda: Relacion për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar:

Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë

Z. Gramoz RUÇI

J. G. Pashaj
T. M. Hoxha
10.12.2018
12.12.18

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 81, pika 1 të saj, në cilësinë e subjektit kushtetues për të ndërmarrë nismë legislative, ne një grup deputetësh propozojmë këtë projektligj. Arsyet e ndërmarrjes së kësaj nisme ligjore janë të shprehura në këtë relacion që shoqëron projektligjin.

Prej 8 ditësh tashmë, studentë nga e gjithë Shqipëria kanë protestuar dhe vazhdojnë të protestojnë për të rritur cilësinë e Arsimit të Lartë në Shqipëri dhe mbi të gjitha për të ulur tarifat e Universiteteve dhe për të përmirësuar infrastrukturën universitare dhe atë të konvikteve të studentëve e cila gjendet në kushte të mjerueshme.

Studentët në kërkesat e tyre zyrtare kanë kërkuar të rritet përfaqësimi dhe ndikimi i tyre në vendimarrje në organet drejtuese të Universiteteve Publike. Ne propozojmë si zgjidhje konkrete për kërkesën e tyre amendimin e “Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Në këto ndryshime të paraqitura prej nesh pasqyrohet qartazi kërkesa e studentëve dhe bëhet e mundur rritja në nivelin 50% e përfaqësimit të tyre në organet vendimarrëse të Universiteteve, pra në Senatin Akademik dhe në të njëjtën kohë rrit peshën e votës së tyre në përzgjedhjen e figurave drejtuese të Universitetit.

Gjithashtu amendimi i Nenit 48 pika 2 bën të mundur përfaqësimin e studentëve në bordin e administrimit dhe gjithashtu siguron barazi në përfaqësim ndërmjet IAL-ve dhe Ministrisë së linjës.

Сопутств. Препорос:

1) Тегзи Мехмет

2) Флора Кирпачи

13/